



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Ministarstvo Trgovine i Industriju-Ministry of Trade and Industry

Inspektorati i Tregut / Trzna Inspekcija / Trade Inspection

I nderuar konsumator,

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë respektivisht Inspektorati i Tregut me qëllim të transparencës në punë dhe informimit të publikut, ka lansuar web site zyrtare [www. itk-ks.org](http://www.itk-ks.org), ku tani e tutje ju keni mundësi të parashtroni ankesat tuaja për mallrat dhe shërbimet e konsumit jashtë standardeve .

Konsumatorët që konstatojnë se mallrat apo shërbimet e konsumit janë jashtë standardit mund të ankohen në inspektorat të tregut përmes sistemit on-line duke shkarkuar formularin e ankesës të cilin e gjeni në këtë ueb site.

Përmes parashtrimit të ankesave tuaja, ju do të kontribuoni në mbrojtjen e të drejtave ekonomike, ligjore të konsumatorit në aspektin e marrëdhënieve jo korrekte me konsumatorin, praktikave të pandershme tregtare apo çdo rast abuzimi që mund të hasen në treg të brendshëm të Republikës së Kosovës.

Në ankesën e parashtruar ju duhet të identifikoni llojin e mallit apo shërbimit (kozmetike apo detergjente, lodra për fëmijë, pajisje elektrike dhe elektro shtëpiake, pajisje të makinerive, produkte të ndërtimit, veshmbathje, naftë dhe derivate të naftës, shërbime të paketë aranzhmaneve dhe shërbimeve hoteliere etj.)

Ankesa mund te parashtrohet për çështjet e mëposhtme :

- Mallin qe keni blere, ka rezultuar i pasigurte për jetën dhe shëndetin tuaj ;
- Malli ka prejardhje te dyshimte;
- Malli apo shërbimi nuk i plotëson cilësitë e parashikuara apo është defektoz;
- Malli apo shërbimi, rezulton me çmime me te larte se sa qe jeni informuar;
- Malli apo shërbimi nuk kthehet edhe pse keni garancion ;
- Malli apo shërbimi i blere nuk shoqërohet me fature ;
- Malli apo shërbimi ofrohet në mënyrë mashtruese (lidhur me informacionin/etiketën, çmimin, cilësinë, sasinë, marrëdhëniet kontraktuale etj.)

Ankesat e konsumatorit do të merren në konsideratë të menjëhershme nga inspektorati i tregut dhe do të investigohen nga inspektorët të cilët do të shqyrtojnë çdo rast duke ju siguruar qe për çdo ankese te parashtruar nga ana e juaj ju do te merrni përgjigje .

Te dhënat dhe informatat e pranuar nga ju te nderuar konsumator, do te mbesin konfidencial për publikun.

Inspektorati i tregut do te beje publike vetëm ato informata te cilat konsiderohen te domosdoshme për te informuar qytetaret, e qe kane te bëjnë me sigurinë e përgjithshme te konsumatorit dhe rrezikun për jetën dhe shëndetin e njerëzve .

E mirëpresim bashkëpunimin tuaj ne realizimin e misionit dhe objektivit te përbashkët për mbrojtjen e konsumatorit .

Ashtu si të drejtat e njeriut përcaktojnë shkallën e zhvillimit të demokracisë, ashtu edhe te drejtat e konsumatorit përcaktojnë shkallën e zhvillimit të ekonomisë së tregut.

Prishtinë
19 dhjetor 2011

Inspektorati i Tregut në MTI